

NGA EKSPOZITA DHE LIBRI ME FOTOGRAFI TË FOTOGRAFISTES  
BRITANIKE MELANIE FRIEND:

## "S'KA VEND MË TË DASHUR SE SHTËPIA"

Fotografitë e Melanie Friends kanë gjetur vend në shumë gazeta dhe revista të njoitura britanike dhe të huaja, si në "The Guardian", "Granta", "The Independent", "Marie Claire", "Newsweek" dhe në "New York Times". Fotografitë e saj rreth Kosovës u botuan më së shumti në "The Times" dhe në "The Guardian". Puna e saj është ekspozuar në Galeri të ndryshme, si në Galerinë e Hjustonit dhe në galerinë Nacionale të Londrës, por edhe në vend e të tjera evropiane si në Suedi etj.

Është ky titulli i ekspositës dhe njëkohësisht edhe i librit me fotografji të fotografistes britanike Melanie Friend, e cila për u mbajt këto ditë në "OCTOBER GALLERY" në Londër. Si reportere e BBC-së, që nga viti 1989 here pas here e kishte vizituar Kosovën dhe Ballkanin në përgjithësi. Krahas fotografisë ajo kishte intervistuar shumë njerëz të thjeshtë të kësaj treve, fotografitë dhe intervistat e të cilëve i ka botuar në vëllimin "S'ka vend më të bukur se shtëpia". Në këtë përbledhje, rezultati së cilës është edhe eksposita e fotografive artistike nga kjo trevë, krahas shqiptarëve, ajo ka prezetuar edhe zërat e pakicave të tjera që jetojnë në këtë trevë. Fotografitë e Melanie Friends kanë gjetur vend në shumë gazeta dhe



Melanie Friends

revista të njoitura britanike dhe të huaja, si në "The Guardian", "Granta", "The independent", "Marie Claire", "Newsweek" dhe në "New York Times". Fotografitë e saj rreth Kosovës u botuan më së shumti në "The Times" dhe në "The Guardian". Puna e saj është ekspozuar në Galeri të ndryshme, si në Galerinë e Hjustonit dhe në galerinë Nacionale të Londrës, por edhe në vend e të tjera evropiane si në Suedi etj. Ajo tani jeton dhe punon në Londër. Të theksojmë me këtë rast se salla ku u mbajt ekspozita qe shumë e vogël për t'i zënë të gjithë të interesuarit shqiptarë dhe anglezë që kishin ardhur për t'i parë këto fotografi, që të kujtonin ditët më të vështira të popullit të Kosovës gjatë luftës së fundit. Në mesin e të pranishëmve ishte Noel Malcolm, historian, Peter Rennie, sekretar i shoqatës Anglo-shqiptare, autorja e ekspozitës dhe shumë miq të tjerë të shqiptarëve. Vëllimi është i ndarë

në disa kapituj. Kapitulli vijues ka të bëjë me jetën e refugjatëve shqiptarë në kampet famëkëqia të Stankovecit, Çegranit etj. në maj-qershor të '99-ës, ndërsa pason kapitulli ku janë prezetuar vendmasakrat më të tmerrshme në Kosovë, siç është vendi ku është bërë masakra e Reçakut e cila ndodhi siç dihet me 15 janar të vitit 1999. Pastaj vendi i masakrës së Lubizhdës, që ndodhi më 12 prill dhe vendmasakra e Celinës e ndodhur më 25 mars po të njëjtë vit.

Kapitullin tjetër ajo do ta titullojë "Ku na duket balta, më eëmbël se mjalta?" dhe do ta ilustrojë me fotot afati artistike të cilat tregojnë kthimin biblik të shqiptarëve mbi rrënojat e shtëpive të tyre, në shkollat-shtëpi të djegura, fëmijë që janë shumë të gëzuar që prapë janë shtëpitë dhe shkollat e tyre... Dhe vërtetë shqiptari, më shumë se çdo kush tjetër duket se është i lidhur shumë me shtëpinë, vendin, atdheun, prandaj edhe fenomeni i kthimit të tyre në këtë mënyrë mahnitë tërë botën, kur u kthyen në vratat e veta madje ende pa u hequr minat nga oborret e tyre! Shumë nga këto ngjarje, pra, gjeten vend në botimin e saj dhe në ekspozitën e saj njëkohësisht, që qe një kënaqësi e madhe për çdo vizitor të ekspozitës. Mikja e Kosovës dhe e kosovarëve Melani në fjalën e rastit e kënaqur nga prezenca e madhe e të pranishëmve falenderoi vizitorët. /Sami ISLAMI

**Në kapitullin e parë përfshihet periudha në mes viteve 1994-95, kur populli i Kosovës, po jetonte i privuar nga çdo e drejtë. I privuar madje edhe për mësimin shqip, e që në këto rethana ai gjeti rrugën e një vetëorganizimi të arsimimit të vet. Dhe atë duke i kthyer shtëpitë në shkolla, moment ky që u regjistrua nga kamera e Melanies.**